

TË NJIHEMI
ME
MEHMET
AKIF ERSOIN

DR. HAJREDIN HOXHA

Të njihemi me mendimtarin shqiptaro-turk

Mehmet Akif Ersojin

Përspektivë kur'anore

Doc.Dr.Hfz. Hajredin Hoxha

***International Islamic University
Kuala Lumpur***

Nga anglishtja

***Edin.Q. Lohja
Recensent:Edin Q. Lohja***

Përmbajtja:

- A- Jeta e tij*
- B- Disa aspekte të jetës së tij private*
- C- Udhëtimet e tij*
- D- Sinqeriteti i tij*
- E- Veprat e tij*
- F- Përkthimet e tij*
- G- Aspekte të mendimit dhe pikëpamjeve të tij*
- H- Të kuptuarit e tefsirit nga ana e tij*
- I- Përfundim*

A- Jeta e tij

Mehmet Akif Ersoy u lind në Stamboll. Babi i tij Mehmed Tahir Efendi (1826-1888) ishte një dijetar i mirënjohur islam, që kishte studiuar në Shkollën islame Fatih. Ai u shpërngul në Stamboll gjatë kohës së Perandorisë osmane nga fshati Sushicë, pranë Pejës së Kosovës qëkur ishte fëmi. Babai i tij u martua me zonjën Emine Sherif Hanim (1836-1926). Më 1878 ai nisi arsimimin e tij në Shkollën Filore Islame Fatih. Që prej asaj kohe ai filloi të mësonte arabishten nga i ati. Ai e vazhdoi studimin e gjuhës arabe gjatë shkollës së mesme, duke filluar ndërkohë mësimin e persishtes jashtë shkollës islame Fatih. Ai lexoi referenca të rëndësishme si Gjylistani i Sadiut, dhe Mesneviu i Rumiut. Në mësimet e turqishtes dhe frëngjishtes ai arriti pikët më të larta, duke shkëlqyer përherë si studenti më i mirë.

Ai kishte inteligjencë të madhe, sidomos në lidhje me mësimin e gjuhëve. Që nga fëmijëria e hershme ai ishte tërhequr nga poezia dhe librat që flisni për dashurinë, sikurse *Mexhnuni dhe Lejlaja*, etj. Nga fundi i vitit 1897 dhe fillimi i vitit 1888 babai i tij u sëmur dhe ndërroi jetë. Admirimi dhe njohja e ndikimit të babait tek ai vazhdoi edhe pas vdekjes së të atit, dhe ai thoshte gjithmonë: *Benim hem baban hem hocamdir. Ne biliyorsam kendesinden ogrendim*, që do të thotë: “E kisha baba dhe mësues. Gjithçka që di e kam mësuar prej tij.”

Pas vdekjes së tij një prej studentëve të tij të spikatur dhe të singertë nisi të kujdesej për familjen e tij, dhe ai u ndërtoi atyre një shtëpi të thjeshtë ku të jetonin. Pasi krey shkollën e mesme, gjendja e tij financiare u rëndua së tepërmi dhe ata mbetën pa burime të ardhurash. Nga fundi i vitit 1889, ai u punësua si mësues në zyrën e

Shkollës Veterinare (*Baytar Mektebi*). Pas katër vitesh përvojë në punë, u hap Shkolla Publike e Mjekësisë, dhe të diplomuarit e shkollës veterinare u punësuan në të.

Në Shtator 1898 ai u martua në moshën 25 vjeçare, me të bijën e Mehmed Emin Bey. Ajo ishte njëzet vjeçë dhe quhej Ismete Hanim. Së bashkë ata patën gjashtë fëmijë: Cemile, Feride, Suad, Ibrahim, Naim, Emin dhe Tahir. Ibrahim ndërroi jetë në moshën një vjeç e gjysëm.

Më 1906 ai u punësua si mësues kaligrafie (*Kitabet Resmiye Muallimi*) në *Halkali Ziraat Mektebi*. Ndërsa më 1907 ai fitoi një vend pune si mësues i gjuhës turke në *Ciftcilik Makinist Mektebi*. Më 1908 ai u rrit në post në zyrën e *Umuri Beytariye Dairesi Mudur Muavini* si ndihmësdrejtor në ndërtesën e zyrës veterinare. Paskëtaj ai u bë pjesëtar i shoqatës remormiste Unitet dhe Përparim, e cila synonte të reformonte programin shkollor dhe të përmirësonte gjendjen e atëhershme, nën platformën e bashkuar të dijetarëve muslimanë suni dhe sufi. Më vonë, ai u bë ligjërues i arabishtes dhe i parimeve të jurisprudencës islame në atë shkollë. Po më 1908 ai u bë pjesëtar i një grupi tjetër të quajtur *Sirati Mustekim Mecmuasi* (Grupi i Rrugës së Drejtë). Anëtarët e kësaj shoqate ishin nga vende të ndryshme islame dhe numëronin 183 veta. Më vonë, kjo shoqatë e ndërroi emrin në *Sebilur Resad*.

B- Aspekte të jetës së tij private dhe të disa veprimtarive të tij

Gjatë studimit në shkollën veterinare, ai ishte shumë aktiv si në jetën fetare, ashtu edhe në atë sportive. Siç përmendëm më lart, ai u përfshi në lexim poezish dhe nisi t'i dërgonte miqve të tij poema, të cilat ata i shijonin shumë. Lidhur me veprimtaritë sportive gjatë studimeve të tij, ai u përfshi në shumë të tilla, sikurse ecjet e gjata, vrapimi, noti dhe hedhja e gjyles. Në të gjitha këto sporte ai ishte më i miri ndër konkurrentët apo sfiduesit. Ai e kishte zakon të notonte matanë Bosforit në Stambollit. Ai gjithashtu ecte nga agimi në muzg pa pushim dhe deri në të pesëdhjetat e vona ishte i mirënjohur në Ankara për këto veprimtari. Po ashtu, për njëfarë kohe ai ngante kuajt dhe u bë kalorës. Të gjitha këto vinin nga ndjenjat dhe përgjegjësitë e tija karshi përgatitjes së ummetit musliman për xhihad.¹

C- Udhëtimet e tija

Kur u emërua nëpunës në zyrat perandorake të Stambollit më 1898, ai nisi udhëtimet në pjesë të ndryshme të Evropës dhe botës arabe, si kryetar i zyrës së veterinarisë. Më 1899 ai u dërgua në Damask për të punuar si doktor veteriner. Vite më vonë ai iu përkushtua me zell thellimit të njohurive të tij nga arabishtja dhe frëngjishtja, për të cilat mori diploma ose çertifikata aftësie për nivelin e tij.

Veç kësaj, ai mësoi përmendësh Kur'anin Fisnik në *Tabhane Medresesinde* nën udhëzimet e profesorit të tij Iskeceli Hafiz Isa. Ai shpenzi gjithashtu dhjetë vjet në Egjipt në Universitetin e Ez'herit

¹Mehmet Akif ersoy, Safahat XVI.

(*Camiatul Misriyede*) due studiuar shkenca islame. Gjatë pushimeve verore ai kthehej në Turqi. Në Ez'her ai studioi gjithashtu letërsi turke, dhe u përfshi në përkthimin e Kur'anit Fisnik në Turqisht. (*Misir'a yerlesmeden TBMM'nce kendisine siparis edilen Kur'an tercumesi uzerine bir muddet clisti ise daha sonra butunyle bu isten vazgecti*).²

Më 1936 ai u sëmur me çregullime të mëlçisë³ (*karacigerinden*) dhe filloi t'ia ndjente mungesën atdheut. Ai u shqetësua shumë se mos vdiste në Egjipt, gjë të cilën nuk e dëshironte assesi. Nga fundi i vitit 1936, shëndeti i tij u përkeqësua dhe ai ndërroi jetë në Stamboll. Varri i tij ndodhet në Edirnekapi pranë mikut të tij të dashur, djetarit Ahmed Naim Efendi.

D- Singeriteti i tij

Rreth singeriteti të tij në shkruajtjen e poezive, mund të përmendim një rast nga viti 1920, kur në gazeta u botua një njoftim konkursi nga qeveria. Ky njoftim kishte të bënte me këngët lirike të vendit (Istiklal Marsi icin Musabaka) që duheshin shkruajtur nga poetët më në zë të kohës, dhe kishte një çmim prej 500 lirash nga qeveria për fituesin. Më shumë se 700 poezi u mblodhën, por shumica nuk kishin lidhje të drejtpërdrejtë me temën e kërkuar.

Ministrit të informacionit Hamdullah Suphi dhe miqve të tij u shkoi mendja te Mehmet Akif Ersoy dhe aftësitë e tij poetike, dhe së bashku e diskutuan çështjen me të, duke ia përmendur çmimin e vendosur nga qeveria. Ai u tha: ***Unë nuk shkruaj poezi për të holla.***

Më në fund ata iu lutën por ai përsëri e refuzoi ofertën e tyre dhe ua bëri të qartë që nëse fitonte, nuk do ta praonte ofertën, dhe ata u pajtuan.

² Ismail Kara, *Turkiye'de Islamcilik Dusuncesi*, p: 312 .

³ Ibid, p:312.

Në Mars 1921 qeveria turke shpalli zyrtarisht këngën e Mehmet Akif Ersoy si më të mirën. Departamenti i financës iu drejtua atij me mesazhin: “Jemi zotuar në dhënien e kësaj shume, kështu që duhet ta merrësh e pastaj mund të bësh çfarë dëshiron me të.” Ai u detyrua t’i merrte paratë, të cilat ia dhuroi të gjitha një shoqate bamirëse.⁴

E- Botimet e tija

Më 1893 ai botoi përmbledhjen e tij të parë (*Mecmuasinda*) me titull *Hazinei Funun* (**Hambari i arteve**). Në këtë vit u botua edhe një prej artikujve të tij romantikë, që fliste për jetën e tij.

Vepra e tij kryesore poetike është *Safahat*, që përfshin shtatë broshura me poezi, të botuara më 1911, pastaj *Suleymanije kursusunde* (1912), *Hakkin Sesleri* (1913), *Fatih kursusunde* (1914), *Hatiralar* (1917), *Asim* (1924) dhe *Golgeler* (Egjypt 1933).

F- Përkthimet e tija

Gjithashtu ai ka përkthyer një sërë librash nga autorë arabë. Për shembull, vepra *Zonja Muslimane* (*Musliman Kadini*) e Ferid Vaxhdiut, *Mbrojtja e Shejh Muhamed Abduhut ndaj Sulmit të Hanotos*, *Përgjigje ndaj Kishës Anglikane* e autorit Abdul Aziz Shaëish, *Konstrukti i politikës në Islam* nga Halim Pasha etj.

He also hold number of lecturers in Kastamonu Mosque as advisor (vaizci). Other books ëere published posthumously ëhich ëere related to the Qur’an and Hadith translations.

⁴ Mehmet Akif Ersoy, *Safahat*, XLIV.

G- Aspekte të mendimit dhe pikëpamjeve të tija rreth Islamit dhe kombeve islame

1- Poet sociolog

Në poezinë e tij shihet qartë shqetësimi i tij dhe shpjegimi për popujt të ndryshëm në vende të ndryshme. Të marrim disa fragmente nga poezitë e tija si shembull.

Ai shkruante:

*Më pyete se ç'popull janë japonezët e largët...
Por e kam vështirë t'i përshkruaj nga të gjitha anët
Mirëpo po të them dicka që rreth tyre kam zbuluar:
Feja e tyre ishte përmbushje e udhëzimeve të Budës
Atje mund të shkosh dhe të gjesh Islamin e kulluar.*

Pas këtij prezantimi, ai donte të bënte një krahasim ndërmjet popullit japonez dhe mësimëve të Islamit. Mendoj se ai e bëri këtë krahasim për t'i inkurajuar muslimanët që të ishin të përpiktë e të mos i shkelnin premtimet; të ishin ndihmues të njeri tjetrit, t'i mbronin të drejtat e të dobtëve, dhe kështu me radhë.

Japonezët i zbatojnë këto urdhëresa e norma, dhe ja përse janë popull i zhvilluar dhe i qytetëruar.

Ai theksonte gjithashtu se

*Në Islam një themel i rëndësishëm duhet njohur,
Mbi të cilin të gjitha çështjet mbështeten,
Dhe kjo është shtylla e teuhidit.
Veç tij është edhe Drejtësia, Përpikmëria, mosnëpërkëmbja,
Mosshfrytëzimi i të dobtëve.*

*Dhe ta ulësh shikimin e të mos e shikosh të ndaluarën
Se njëherë do vdesësh dhe do lësh pas gjithçka ke pasur,
Ndaj përpiku e kupto kuptimin e flijimit.*

Në fund ai thotë:

*Shpresoj që Islami do të ndriçojë atje shumë shpejt.
Por osmanët duhet të punojnë fort dhe me durim,
Për t'i mbrojtur ata nga viktimizimi prej misionarëve të krishterë që
aq fort përpiquen.
S'e kuptoj çfarë presin dijetarët islamë.
Mos presin ndonjë shpallje nga Zoti që t'i urdhërojë të shkojnë
atje?!⁵*

2- Feja

Autori kishte kuptuar një pikë me rëndësi në mesin e njerëzve me intelekt, dhe kjo ishte se mes tyre ka një keqkuptim të madh të shpirtit të Islamit, dhe ja përse ata nuk i tërhiqte Islami.

*Ai shkruan: Ata nuk e kanë kuptuar shpirtin e Islamit akoma, sepse burimet nga ku mësojnë rreth Islamit janë të gabuara. Ata pandehin se nuk mund të jenë komb i qytetëruar po ndoqën Islamin.
Ata nuk e dinë se dija u çmua në përjetësi nga Zoti (kur ia mësoi Emrat të dërguarit të Tij të parë, Ademit, paqja qoftë mbi të).*

Në fund, ai thotë: *Dy gjëra nuk kuptoj për ata mendjendritur: ose janë budallenj (ahmak), ose kanë tepër frikë ta diskutojnë çështjen.
Ata pandehin se Evropa është e qytetëruar dhe ateiste, kështu që nëse dëshirojmë të qytetërohemi u dashka të jemi si ata!?*⁶

⁵Turkiye'de Islamcilik Dusuncesi, ff. 319-320.

⁶Ibid, p: 332-333

3- Qëndrimi i tij ndaj Xhemal ed-Din Afganit

Në disa prej poezive dhe artikujve të tij ai na shfaqet si dijetar dhe autor mbështetës. Në një rast ai shkroi një artikull të rëndësishëm në të cilin mbronte Xhemal ed-Din Afganin, duke vërtetuar se të gjitha akuzat e bëra ndaj tij ishin të pabaza dhe shpifje. Ky artikull ishte i tëri rreth admirimit të tij për Shejh Xhemal ed-Dinin. Ndër punimet e tij të shumta të botuara dhe të pabotuara që ai la pas ishte edhe studenti i tij Shejh Muhammed Abduh, i cili mbajti postin shumë të rëndësishëm të Shejhut të Ez'herit në Egjipt.

Njëherë, kur Shejh Xhemal ed-Dini shkoi në Stamboll, ai u prit nga Sulltan Ali Pasha. Në Perandorinë Osmane ishte zakon që kur dikush nderohej me hyrje në pallatin e Sulltanit, ai duhej nderuar e respektuar edhe nga të tjerët.

Pas gjashtë muajsh Shejh Xhemal ed-Dini u emërua në Ministrinë e Arsimit. Shejhul Islami në atë kohë kishte disa probleme dhe mospërputhje personale me Shejh Xhemal ed-Dinin dhe kërkonte një mënyrë për t'u hakmarrë ndaj tij duke e pushuar nga posti që ai mbante.

Në Ramazan 1287/Dhjetor 1870 drejtori i Darul Fununit (sot Universiteti i Stambollit) Tahsin Efendiu kërkoi të kishte një diskutim me Shejh Xhemal ed-Dinin rreth kurseve mësimore dhe shkencave. Njohuritë e Shejh Xhemalit nga turqishtja nuk ishin fort të mira dhe ai nuk dëshironte të hynte në diskutim, por më në fund u pajtua.

Kur erdhi koha për çeljen zyrtare të Darul Fununit, të gjithë ministrat, intelektualët, dijetarët islame dhe princat u mblodhën për të dëgjuar fjalën e Shejh Xhemal ed-Din Afganit. Mes tyre ishte edhe Shejhul Islami. Nga e tërë ligjërata e Shejh Xhemal ed-Dinit ai mbajti mend vetëm këto fjalë:

Jeta e kësaj bote mund të krahasohet me trupin e një njeriu, dhe nëse diçka nuk shkon në trup ajo do ta ndikojë për keq krejt organizmin. Për shembull, përdorimi i pronës dhe i pasurisë varet nga udhëzimi dhe urhdërimi i trurit. Është krejt e njëjta gjë.⁷

Autori i artikullit, Mehmet Akif Ersoy shkruan se Shejh Xhemal ed-Dini e kishte zakon të bënte krahasime të tilla në fjalimet e tij. Por Mehmet Akif vazhdon e thotë se Shejh Xhemal ed-Dini më në fund e mbylli pohimin e tij, ndërsa Shejhul islami debatoi me diçka tjetër.

Shejh Xhemal ed-Din tha: Lumturia e njeriut është ndërtuar e tillë, trup dhe shpirt. Po të mos ketë shpirt në këtë trup, ky i fundit nuk mbijeton dot e as nuk arrin të ekzistojë. Kështu që lumturia e njeriut është profetësia (peygamberlik) por ka dallime mes asaj dhe kësaj. Profetësia jepet nga Allahu s.v.t. Ajo nuk arrihet me adhurim ose përpjekje, sepse Allahu thotë në Kur'anin Fisnik: "Allahu e di më së miri se ku e vendos Mesazhin e Tij" (el-En'am:124). Kështu që ne mund të mësojmë shumë nga të menduarit e drejtë, kurse i dërguari është i mbrojtur nga keqbërja, ndryshe nga gjykuesi-i urti-filozofi (hakim) që mund të gabojë. Duke e kuptuar këtë pikë mund të themi se dija e dhënë nga të dërguarit u mbrojt nga Allahu s.v.t. prej sulmeve të armiqve dhe duhet besuar fuqimisht. Ndërsa mospajtimi i mbështetur në dije dhe arsye lejohet për disa dijetarë islamë.⁸

Nga ky pohim Shejhul Islami kishte kuptuar se Xhemal ed-Din Afgani thotë dhe beson që profetësia (*nubuvveh*) është një lloj zanati (*bir nevi sanattir diyor*). Mbështetur në këtë akuzë, Shejhul Islami e dënonte dhe ulte Xhemal ed-Dinin, por në realitet kjo nuk kishte të bënte aspak me akuzimin.

Paskëtaj Shejhul Islami i urdhëroi imamët dhe hatibët në të gjitha xhamitë që të flisnin rreth këtyre akuzave dhe t'i përhapnin ato gënjeshtër (Buhatanlar). Atëherë, Shejh Xhemal ed-Dini kërkoi ta çonte çështjen në gjyq, por askush nuk e përkrahu në këtë nismë.

⁷Turkiye'de Islamcilik Dusuncesi, pp. 363-4.

⁸Ibid,p:364.

Pastaj çështja u diskutua dhe u përhap nëpër gazeta, disa prej të cilave mbështesnin Shejhul Islamin e të tjera Shejh Xhemal ed-Dinin. Pas njëfarë kohe, ai u detyrua ta linte Stambollin dhe të shkonte Egjipt.

Kështu që saherë ka një diskutim rreth dijes, meritës dhe epërsisë (*fazileti*), si dhe qëndrimit të Shejh Xhemal ed-Dinit është shumë e turpshme dhe e keqe të akuzohet se ai nuk besonte në profetësinë e të Dërguarve të Allahut s.v.t. Ata që e thonë këtë janë njerëz që nuk e dëgjojnë dhe nuk i kuptojnë fjalimet e tija.

“Dy janë tiparet që e ndajnë të rremen nga e vërteta: Siguimi që ky informacion është i vërtetë, si dhe aftësia për ta kuptuar drejtë atë.”⁹

Qëllimi i kësaj ndodhie të gjatë në këtë punim të shkurtër është të kuptuarit e pikëpamjeve të Mehmet Akif Ersoy rreth mbështetësve të modernizmit dhe reformizmit. Kështu që ky është një pohim shumë i qartë ku ai ka treguar mbështetje të fortë dhe mbrojtje të Shejh Xhemal ed-Din Afganit, Allahu i mëshiroftë që të dy.

H- Të kuptuarit e tefsirit prej tij

Në komentin e tij të fjalës së Allahut në Kur'anin Fisnik: *Kur atyre u thuhet: Ndiqni atë që ka zbritur Allahu, ata thonë: Jo, por do të ndjekim atë në të cilën i gjetëm etërit tanë. Edhe pse etërit e tyre nuk kuptonin asgjë e as nuk ishin të drejtudhëzuar.* (el-Bekareh:170)

Ndër komentet e tija për këtë ajet fisnik është se duhet të bëjmë kujdes ndaj sajësive - bidateve në fe. Efektet negative të sajësive në çështje fetare mjaftojnë për t'i lëkundur dhe shkatërruar shtyllat e Islamit. Duke shkatërruar fenë tonë në shkatërrojmë jetën tonë. Në Islam nuk ka ndarje mes fesë (din) dhe kësaj bote (dunja). Historia

⁹ Turkiye'de Islamcilik Dusuncesi, p: 365 .

na mëson se kjo nuk ka ndodhur kurrë në të kaluarën. Muslimanët sundonin nëpërmjet Islamit. Ata që duan t'i imitojnë të tjerët në çështjet e botës ose të fesë, në kulturë dhe në tradita, nuk kontribuojnë në mbijetimin ose ringjalljen e shoqërive të tyre.¹⁰

G- Përfundim

Për këtë mendimtar, dijetar dhe poet të madh islam ky studim është veçse një hyrje për studime më të thella të mëtejshme, me qëllim gjetjen e pikëpamjeve të tija rreth islamit dhe muslimanëve. Shpresoj se do të më jepet rasti për diçka të tillë në të ardhmen in sha Allah.

Ves selamu aleikum ve rahmetullah ve Berekatuh

Mr.Hfz.Hajredin Hoxha
International Islamic University Malaysia
Qur'an & Sunnah Department
Kuala Lumpur

20.09.2000.

¹⁰ Ky artikull citohet nga gazeta *Sebiluresad*, IX, sayi :209,(23,Ramazan 1330, i shkruar nga Mehmed Akif Ersoy. Se Tukiye'de Islamcilik Dusuncesi, ff. 365-9.